

Alkoolizmi

karakterizohet me rritjen e tolerancës dhe varësisë psikike nga alkooli. Efektet afatgjate nga përdorimi i alkoolit kyçin: cirozë në mushkërinë e zezë, pankreatitis, epilepsi, polinuropati, demencion alkoolik, sëmundje në zemër, deficit nutritiv dhe disfunksionim seksual, si dhe rrezik për kancer. Çrregullimet mentale gjatë përdorimit afatgjatë të alkoolit janë demencioni, dëmtimi i funksioneve të trurit, anksozitet, depression, shizofreni, panikë.

Alkoolizmi lidhet me probleme martesore, dhunë familjare, lërje anësh dhe keqpërdorim të fëmijëve, humbje të punës.

Shenjat specifike të alkoolizmit janë: amnezia, humbja e kontrollit të të pierjes dhe sjelljes, rritje dhe rënie të tolerancës dhe sindrom apstinencial.

Alkoolikët manifestojnë:

- Tolerancë ekstreme të ulët të frustrimeve
- Paaftësi për durimin e anksonimit dhe

shtypjes

- Narcizëm ekstrem
- Reagime sekundare psikologjike të pranishme janë:
- Hipersenziviteti
- Impulsiviteti
- Ndjenja e izolimit dhe gjykimit
- Mëni
- Ambiciozitet
- Tendencë mazohiste-sadiste

Simptomat e të dëgjuarit: anksozitet, shqetësim, pagjumësi, shtypje të lartë të gjakut, temperaturë, puna e zemrës dhe frymëmarrjes përshpejtohet, dobësi në zemër, huti, dezorientim, halucinacione, shtangie, deri në vdekje.

Një numër i madh të cilët konsumojnë alkool i bartin pasojat si: dënime, aksidente në komunikacion, probleme shëndetësore, lëshim i mësimin etj.



Црвен крст на Република Македонија
Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë

THE CHURCH OF
JESUS CHRIST
OF LATTER-DAY SAINTS

ALKOOLIZMI

Organizata botërore e shëndetësisë alkoolizmin e definoi si "Pijanec apo thjeshtë thënë pijanec llogaritet ai person i cili konsumon alkool tej mase, tek i cili është zhvilluar varshmëria psikike dhe fizike nga alkooli, që tregon çrregullime somatoneurologjike dhe shpirtërore në sjellje që dukshëm tregon për dëmtimin e shëndetit psikik dhe fizik, gjegjësisht edhe çrregullim të gjendjes sociale dhe ekonomike të personit".

Sot, alkoolizmi paraqet problem kompleks dhe llogaritet për toksinomaninë me masive dhe një ndër problemet më serioze sociale – mjekësore të shoqërisë bashkëkohore. Pasojat të cilat alkooli i shkakton tek njeriu, nga aspekti mjekësor tërheqin vëmendjen e aftësisë së përgjithshme për punë dhe uljen e funksionimit të tij normal. Shikuar nga aspekti sociopatologjik, problem shumë më i madh është devijimi, t.e. sjellja asociale përcjellur me veprime kriminale si pasojë e alkoolizmit. Interes të posaçëmsociologët, psikologët dhe andragozët shprehin për problemet të cilat alkoolizmi i shkakton në familje, që si qelizë e posaçme e ndërtuar në çdo shoqëri paraqet faktor primar për zhvillimin e personalitetit, posaçërisht për zhvillimin psikofizik dhe emocional dhe socializimin primar.

WWW.REDCROSS.ORG.MK

www.facebook.com/CrvenKrstNaRepublikaMakedonija

www.youtube.com/MacedonianRedCross

Botimi i kësaj fletushke në mënyrë financiare është përkrahur nga

THE CHURCH OF
JESUS CHRIST
OF LATTER-DAY SAINTS

Përhapja

Sipas të dhënave të Organizatës botërore të shëndetësisë në botë ka rreth 140 milion alkoolikë. Në Republikën e Maqedonisë ka 40-60 mijë alkoolikë, apo 2-3% të popullatës janë alkoolikë. 80% nga prodhimi i rrushit dhe pemëve përpunohen në alkool. Në Republikën e Maqedonisë alkooli merr pjesë me 12% si faktor për fatkeqësi, rëndë të lënduar dhe vdekje gjatë fatkeqësive. Etil alkooli është i përfaqësuar prej 3-7% në birra, 6-14% në verë, 30-50% në liker, 16-55% në raki dhe 45-50% në konjak.

Ndikimi i alkoolit në organizëm

Alkooli e dëmton pothuajse secilin organ në trup.

Dëmtimet e organeve të brendshme:

Sistemi digjektiv: kanal in e të ushqyerit, lukthin, mushkërinë e zezë, pankreasin.


Sistemin nervor qendror dhe periferik

Zemra dhe sistemi vaskular

Dëmtimi i veshkëve

Ndryshime të lëkurës – pelagra

Shkatërrim trupor – humbje të sasisë muskulore



Delirium tremens

Predelirium: ëndërra trishtuese, frikë, shqetësim, huti, pagjumësi, djerstitje, puls të përshpejtuar, kokëdhembje.

Delirium: përnjëherë: halucinacione në të pamurit, halucinacione akustike, ide të çuditshme, paranojë, imiton profesion, temperaturë, vetëdije të shkatërruar, nuk flet, nuk han, djerstitet shumë, puls të dobët, bie shtypja, dridhen duart, të folur të pakuptueshëm, sulme epileptike, gjum të thellë që zgjat 3-4 ditë.

Halucinozë alkoolike

Psikozë korskau

Dëmtim të nevave periferik

Atrofia e trurit

Gjakderdhje në pika në masën gri të trurit

Alkooli e shkurton jetën për 15 – 20 vjet



Alkoolik është person i cili vazhdimisht dhe përtej mase konsumon pije alkoolike, që sjell në çrregulime shpirtërore apo dëmtime të shëndetit psiqik dhe fizik, vështirësi në raportet me të tjerët dhe dëmtim të gjendjes sociale dhe ekonomike. Ai nuk mund ta kontrollojë pirjen e alkoolit (humbje të aftësisë për kontrollimin e përdorimit të tepërt të alkoolit) që sjell deri te varësia.